

VENDIM
Nr. 78, datë 29.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 29.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (V) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Vladimir Vladimirov, përfaqësuar nga avokati Isuf Shehu, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Sotir Kllapi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 488 akti, datë 19.9.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 214 (87-2024-306), datë 28.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-214, datë 6.2.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës, si dhe të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Asgjësimi i kopjeve të korrespondencës dhe të dhënave personale të nxjerra nga celulari i kërkuesit që nuk lidhen me objektin e hetimit penal.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, pika 1, 35, 36, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 8 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 7 i Kartës të të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Vladimir Vladimirov (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e publikimeve të disa transkripteve të bisedave të përgjuara nga autoritetet italiane, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 17, datë 25.1.2021, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve që ushtrojnë funksione publike”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale e veprimtarisë kriminale”, të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 259, 287, 28, paragrafi 4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal (KP). Nga të dhënat e hetimeve për disa procedura të prokurimit publik të realizuara në vitin 2019, me objekt furnizimin e spitaleve me oksigjen të lëngshëm dhe të gaztë, kanë rezultuar fituese shoqëritë “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” sh.p.k., me administrator shtetasin B. H. dhe “Messer Albagaz” sh.p.k., me administrator kërkuesin, shtetas bullgar. Sipas Prokurorisë së Posaçme, ka dyshime të arsyeshme se këto procedura kanë qenë të paracaktuara dhe në marrëveshje të fshehtë ndërmjet shoqërive dhe autoritetit kontraktor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Zyrtarët e kësaj të fundit kanë ndarë qëllimisht fondin limit, me qëllim për të favorizuar operatorët vendas dhe konkretisht këto dy shoqëri si bashkim operatorësh. Po kështu, pavarësisht se kërkuesi rezultoi administrator i shoqërisë, për transaksione që tejkalojnë shumën 10.000 euro ka kërkuar miratimin e menaxherit teknik, S.A. dhe shefit të financës, M. Z.

2. Në këto kushte, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë me objekt kontrollin personal të 12 shtetasve (shtetasit B. H., administrator i shoqërisë “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” sh.p.k., bashkëshortes së tij dhe 4 punonjësve të kësaj shoqërie, 2 administratorëve të dy shoqërive të tjera, të cilat janë përfshirë në transferta parash me të parën, administratorit të shoqërisë “Sofigaz” sh.p.k., i cili rezultoi në marrëveshje me shtetasin B. H. dhe 3 punonjësve të shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k.), me qëllim zbulimin e provave dhe sendeve që mund të kenë lidhje me veprën penale, si prova dokumentare dhe elektronike. Kërkuesi nuk rezultoi të jetë ndër personat për të cilët është kërkuar kontrolli personal.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 299 akti, datë 19.5.2024 (*vendimi nr. 299/2024*), ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lejimin e kontrollit personal të këtyre shtetasve, duke argumentuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se janë konsumuar elementet e figurës së veprës penale; për qëllime të procedimit penal prokuroria arriti të bindë gjykatën se ka arsye të bazuara për të menduar se këta persona mund të fshehin prova materiale ose sende që i përkasin veprave penale për të cilat procedohet; me anë të kontrollit synohet të gjenden prova materiale të cilat nuk janë arritur të merren dhe në pamundësi të ndërhyrjes për marrjen e tyre nga Policia Gjyqësore e prokurori, për shkak të mospasjes të së drejtës ligjore, duhet që ky veprim të kryhet me një kërkesë të gjykatës, sipas kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 202 të KPP-së; qëllimi i kontrollit është sekuestrimi i pajisjeve elektronike si telefona, kompjuterë, laptop, etj., dokumente të ndryshme të cilat pasqyrojnë lëvizje të transaksioneve monetare, tituj pronësie, akte noteriale, por pa u kufizuar në to, si dhe sende të tjera që lidhen me veprën penale. Sipas gjykatës, objekti i këqyrjes dhe ekspertimit të pajisjeve elektronike do të jetë vetëm marrja e të dhënave kompjuterike që lidhen ngushtësisht me objektin e hetimit, duke përjashtuar ato të dhëna që nuk kanë lidhje me veprën penale. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi.

4. Po kështu, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë për kontrollin e banesave, ambienteve dhe zyrave të disa individëve dhe shoqërive të përfshira në hetim, ndër të cilat edhe të shoqërisë në të cilën është administrator kërkuesi, me qëllim zbulimin e të dhënave që kanë lidhje me veprën penale dhe provave materiale, dokumentare dhe elektronike.

5. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 300 akti, datë 19.5.2024 (*vendim nr. 300/2024*), ka vendosur pranimin e kërkesës dhe, ndër të tjera, lejimin e kontrollit të zyrave të selisë së shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k. Sipas kësaj gjykate, ekziston dyshimi i arsyeshëm i

bazuar në prova se janë konsumuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal; ka arsye të bazuara në prova se në vendet ku kërkohet kontrolli mund të gjenden prova materiale ose sende që u përkasin veprave penale, konkretisht mund të gjenden gjurmë të veprës penale dhe të sekuestrohen provat materiale të mundshme që ndihmojnë në hetimin e çështjes; provat materiale që synohen të gjenden nuk janë arritur të merren dhe në pamundësi të ndërhyrjes për marrjen e tyre, duhet që ky veprim të kryhet me kërkesë sipas nenit 202 të KPP-së. Sipas gjykatës, qëllimi i kontrollit është sekuestrimi i pajisjeve elektronike si telefona, kompjuterë, tituj pronësie, akte noteriale, por pa u kufizuar në to, si dhe sende që lidhen me veprën penale. Objekti i këqyrjes dhe ekspertimit të pajisjeve elektronike do të jetë vetëm marrja e të dhënave kompjuterike që lidhen ngushtësisht me objektin e hetimit, duke përjashtuar ato të dhëna që nuk kanë lidhje me veprën penale.

6. Kontrolli i ambienteve të shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k. është kryer në datën 21.5.2024. Në kushtet kur kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë procedurës së kontrollit të zyrave, oficerët e Policisë Gjyqësore, bazuar në nenet 202–207 dhe 298, të KPP-së, kanë proceduar edhe me kontrollin personal të kërkuesit. Sipas procesverbalit të kontrollit personal të datës 21.5.2024, gjatë kontrollit është gjendur një telefon celular me dy karta *SIM*. Në këto kushte është vijuar me sekuestrimin e telefonit, për të cilin është mbajtur procesverbali përkatës për sekuestrimin e provës materiale po i datës 21.5.2024, i nënshkruar edhe nga vetë kërkuesi. Sipas këtij procesverbali të fundit, sekuestrimi është bërë me iniciativën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, bazuar në vendimin nr. 299 akti, datë 19.5.2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe në bazë të neneve 300 dhe 301 të KPP-së. Po kështu, rezulton se prokurori ka vlerësuar të ligjshëm sekuestrimin në datën 22.5.2024. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me ankim kundër sekuestrimit të telefonit celular sipas procesverbalit të oficerit të Policisë Gjyqësore, duke kërkuar kthimin e tij.

7. GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 488 akti, datë 19.9.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj. Kjo gjykatë ka arsyetuar se me vendimin nr. 300/2024 është konsideruar e bazuar në ligj dhe në prova kërkesa për kontrollin edhe të zyrës së shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k. Sipas saj, disa nga pretendimet e mbrojtjes lidhen me thelbin e vendimit të kontrollit, i cili është një vendim i paankimueshëm. Ndërkohë, lidhur me pretendimin se kontrolli i kërkuesit nuk ka qenë pjesë e vendimit të kontrollit të lejuar nga gjykata, ajo gjykatë ka vlerësuar se ky veprim i organit procedues nuk është në kundërshtim me ligjin, pasi kontrolli personal mund të bëhet në çdo ambient ku mund të gjendet personi, mjafton që ky veprim të jetë autorizuar nga gjykata. Pra, sipas nenit 205 të KPP-së, organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm, kur çmon se këta mund të fshehin provën materiale ose sendet që i përkasin veprës penale dhe mund të urdhërojnë që të pranishmit të mos largohen para se të mbarojë kontrolli dhe të kthehen forcërisht ata që largohen. Në rastin konkret, sipas gjykatës, kërkuesi është gjendur në ambientet ku është ushtruar kontroll dhe i është sekuestruar pikërisht prova materiale që ka qenë objekt i kontrollit të ambienteve. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

8. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 214 (87-2024-306), datë 28.10.2024, ka vendosur miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se në zbatim të vendimeve të gjykatës që kanë lejuar kontrollin personal dhe të vendeve është realizuar sekuestrimi i sendeve dhe gjatë kontrollit të vendeve është konstatuar prania e kërkuesit, i cili i është nënshtruar kontrollit fizik, duke iu sekuestruar një telefon celular në cilësinë e provës materiale. Po sipas gjykatës, neni 301 i KPP-së ka lejuar sekuestrimin e ndërmarrë me iniciativë nga Policia Gjyqësore, ligjshmëria e të cilit kontrollohet nga prokurori brenda 48 orëve nga marrja e aktit përkatës. Sipas saj, nga të dhënat e pasqyruara në procesverbalin për kontrollin e vendeve të datës 21.5.2024, ora 11:00, rezulton se veprimi është kryer nga oficerët e Policisë Gjyqësore, duke u bazuar në nenet 205 dhe 300 të KPP-

së, të cilët kanë vendosur sekuestrimin edhe të telefonit celular të kërkuarit, duke e konsideruar si send që lidhet me veprën penale, me dyshimin se në këtë pajisje mund të gjenden komunikime me zyrtarët e autoriteteve kontraktore, referuar dyshimeve të ngritura në kuadër të hetimeve që po zhvillohen për procedimin penal nr. 17/2021. Në këto rrethana, GJKKO-ja e Apelit e ka gjetur të bazuar aktin e sekuestrimit të telefonit celular të kërkuarit nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe vendimmarrjen e datës 22.5.2024, të Prokurorisë së Posaçme për vlefshësin si të ligjshëm në bazë të nenit 301/2 të KPP-së, me argumentimin se “lidhen dhe ofrojnë të dhëna për faktet objekt hetimi”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuar.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-214, datë 6.2.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjërin prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së. Sipas tij, gjykatat më të ulëta kanë argumentuar pabazueshmërinë e pretendimeve të kërkuarit. Për pretendimin se kontrolli personal nuk ishte autorizuar me vendim gjyqësor, ai ka vlerësuar se, sipas nenit 205 të KPP-së, organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm kur çmon se ata mund të fshehin prova materiale ose sende që i përkasin veprës penale. Po sipas tij, në fazën e hetimeve paraprake, organi procedues është prokuroria, e cila, rrjedhimisht, vendos edhe për fatin e sendeve të sekuestruara me cilësinë e provës materiale, të cilat janë në funksion të hetimit. Ai kolegji është shprehur se: vendimmarrja e gjykatave është një vendimmarrje logjike dhe e mirargumentuar; nuk konstatohet moszbatim i ligjit penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk konstatohen shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; nuk rezulton që vendimi i rekursuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

10. Në datën 14.8.2025 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuar i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kriterëve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 11.9.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 26.11.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkuar, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

11.1 *Të drejtën për jetë private* në drejtim të *paprekshmërisë së banesës, mbrojtjes së korrespondencës dhe të dhënave personale, si dhe integritetit fizik e personal*, të garantuara nga nenet 35, 36 dhe 37, pika 3, të Kushtetutës, pasi ndaj kërkuarit nuk ka një vendim gjyqësor për kontrollin personal. Oficeri i Policisë Gjyqësore ka vepruar në bazë të një autorizimi të përgjithshëm për kontrollin e vendeve, duke e zgjeruar më tej në kontrollin personal pa një bazë ligjore. Vendimi për vlefshësin e kontrollit nuk i është komunikuar kërkuarit. Sekuestrimi është bërë pa garanci ligjore të qarta dhe pa respektuar procedurat e duhura për kontrollin personal të kërkuarit.

Referimi në procesverbalin e kontrollit personal të vendimit nr. 299 akti, datë 19.5.2024, i cili disponon për kontrollin personal të disa shtetasve të tjerë, cenon *parimin e sigurisë juridike*. Prokuroria e Posaçme ka bërë një interpretim të zgjeruar të nenit 205, pika 4, të KPP-së, por ai nuk zëvendëson nenin 204, i cili autorizon kontrollin personal. Prokuroria fillimisht nuk ka pasur dyshime për kërkuarin dhe vetëm pasi është konstatuar prania e tij në ambientet e shoqërisë, është kryer kontrolli nga oficeri i policisë. Telefoni celular nuk mund të trajtohet si send material për

efekt të sekuestrimit. Gjithashtu, mungon kohezioni ndërmjet veprimeve procedurale dhe krijohet dyshimi se po hetohet personi me qëllim për t'iu atribuar një vepër penale dhe kontrollat përbëjnë një *fishing expedition*. Në drejtim të proporcionalitetit, Prokuroria e Posaçme nuk ka provuar se përse nuk mjaftonte kontrolli i ambienteve të shoqërisë dhe dokumentacionit financiar, kontabilitetit, *email*-eve zyrtare ose sistemit IT të shoqërisë, si dhe nuk ka shpjeguar përse përdorimi i telefonit personal të administratorit është domosdoshmërisht i nevojshëm dhe pse nuk mund të kufizohet në segmente të caktuara, si për shembull komunikime me një subjekt konkret, në një periudhë të kufizuar.

11.2 *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara bien ndesh me vendime të mëparshme të Gjykatës së Lartë, sepse ato nuk kanë analizuar mungesën e autorizimit individual për kontrollin personal të kërkuarit.

11.3 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.3.1 *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk kanë identifikuar cilat prova do të merren nga kontrolli dhe për më tepër nuk përmendin nominalisht kërkuarin, për të cilin duhet të kishte një dyshim konkret dhe të justifikuar. Kontrolleve të lejuara me vendimet nr. 299/2024 dhe nr. 300/2024 u mungon qëllimi, pasi objekti i sekuestrimit përcaktohet në terma të gjerë, si dhe nuk analizohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm për kërkuarin. Edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin njësoj nr. 1, datë 30.6.2017, kanë përcaktuar se nuk është i mundur përdorimi i kontrollit pa vendim të gjykatës e me iniciativën e Policisë Gjyqësore dhe në rastin konkret gjykatat nuk kanë respektuar vendimet unifikuese të asaj gjykate.

11.3.2 *Së drejtës së ankimit*, pasi mungesa e një mjeti efektiv për kundërshtimin e vendimeve të kontrollit përbën shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

12. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

12.1 Pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara, pasi sekuestrimi i telefonit celular të tij nuk është bërë mbi bazën e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë nr. 299/2024, që lidhet me kontrollin personal, por mbi bazën e vendimit nr. 300/2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë që lidhet me kontrollin e vendeve ose ambienteve. Kontrolli personal i personave që mbanin pozicione kyçe në shoqëritë tregtare të cilat kanë rezultuar fituese në disa procedura prokurimi ishte i nevojshëm, me qëllim sigurimin e provave dokumentare dhe atyre elektronike për të qartësuar rrethanat e faktit objekt hetimi. Për kërkuarin nuk është kërkuar fillimisht kontrolli personal dhe i banesës, pasi kur është paraqitur kërkesa e organit të prokurorisë ai ndodhej jashtë vendit. Pas kthimit të tij në Shqipëri, kërkuari është gjendur në ambientet e shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k. në kohën kur është ushtruar kontroll dhe me iniciativë të oficerit të Policisë Gjyqësore, bazuar në nenin 205, paragrafi 4, të KPP-së, është bërë kontrolli personal i tij si administrator i shoqërisë dhe sekuestrimi i telefonit. Ky sekuestrim është bërë brenda objektit të kontrollit të vendeve të lejuara me vendim gjykate, por nuk mund të konsiderohet rastësor. Për rrjedhojë, ndërhyrja në jetën private të kërkuarit është e ligjshme, e parashikuar dhe e rregulluar nga dispozita ligjore, si dhe është proporcionale.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe

134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 21, datë 22.4.2025; nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, sipas nenit 16, pika 1, të Kushtetutës, të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëloj edhe për të huajt. Në rastin konkret, Gjykata vëren se edhe pse në ankimin kushtetues individual kërkuar ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të cilat kanë rrëzuar ankimin e tij kundër sekuestros së provës materiale (telefon celular) në pronësi të tij dhe kërkesën për kthimin e këtij sendi, ai ka pretenduar, ndër të tjera, edhe cenimin e së drejtës së paprekshmërisë së banesës, të garantuar nga neni 37, pika 1, i Kushtetutës. Kjo dispozitë përfshin në fushën e mbrojtjes së saj jo vetëm banesën e individit, por edhe çdo mjedis tjetër që është i tillë që të njësohet me të. Sikurse Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj, selia/zyra e personit juridik, ku individ ushtron veprimtarinë e tij profesionale, përbën mjedis të njësuar me banesën, në kuptim të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, ndaj paprekshmëria e saj është e garantuar (*shih vendimin nr. 42, datë 1.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se objekt i vendimeve të kundërshtuara ka qenë vetëm ankimi kundër sekuestros së provës materiale (telefon celular), ndërsa pretendimet e kërkuar lidhen me kontrollin personal të ushtruar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, që është pasuar me sekuestrimin e telefonit celular vetjak dhe jo me kontrollin e ambienteve të zyrës ku ushtron aktivitetin shoqëria në të cilën ai është administrator. Kërkuar u është drejtuar gjykatave të zakonshme e më tej kësaj Gjykate jo në cilësinë e administratorit të shoqërisë, pra si mbrojtës i të drejtave të saj, por si individ, person fizik. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuar nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimin e cenimit të së drejtës së paprekshmërisë së banesës. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, ai ka qenë palë në proces dhe justifikon interesin në çështjen e parashtruar dhe, për rrjedhojë, legjitimohet *ratione personae*.

16. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, vendimet e ndërmjetme të sekuestros, të dhëna gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues, edhe pse gjykimi i themelit të fajësisë ende nuk kishte përfunduar, duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për sa kohë ato ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 42, datë 1.7.2025; nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individ në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual. Ndërsa nëse nga kontrolli nuk gjenden sende për t’u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t’i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues

individual (*shih vendimet nr. 42, datë 1.7.2025; nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në gjykatat e zakonshme dhe në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka ngritur pretendime jo vetëm për masën e sekuestrimit të telefonit celular, por edhe për procedurën e kontrollit personal. Ndërsa gjykatat për këtë të fundit janë shprehur se vendimi i kontrollit nuk është i ankimueshëm, Gjykata, në referim të jurisprudencës së saj të lartpërmendur, përderisa nga kontrolli janë sekuestruar sende dhe kërkuesi ka ankimuar vendimin e sekuestros, vlerëson se ai i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Po kështu, edhe për vendimet që kanë vlerësuar masën e sekuestrimit, kërkuesi i ka paraqitur më parë pretendimet, në formë dhe në substancë, përpara gjykatave të zakonshme, prandaj ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, ndaj edhe ky kriter plotësohet.

18. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, i Gjykatës së Lartë, mban datën 6.2.2025 dhe i është komunikuar mbrojtësit të kërkuesit në adresën elektronike në datën 17.4.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 14.8.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime në lidhje me cenimin e *së drejtës për jetë private*, në drejtim të *mbrojtjes të të dhënave personale, fshehtësisë së korrespondencës dhe integritetit fizik e personal; së drejtës për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit dhe së drejtës së ankimit; si dhe të parimit të barazisë përpara ligjit dhe të parimit të sigurisë juridike*, të garantuara nga nenet 18, 35, 36, 37, pika 3 dhe 42 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 8 të KEDNJ-së.

20. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës së ankimit*, kërkuesi ka ngritur argumentin se mungesa e një mjeti efektiv për kundërshtimin e vendimeve të kontrollit përbën shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Gjykata çmon të risjellë në vëmendje qëndrimin e saj se ligjvënësi duhet të vlerësojë nëse legjislacioni procedural penal duhet të plotësohet, me qëllim që individit t’i ofrohen mjete juridike efektive për kundërshtimin përpara gjykatave të zakonshme të masës së kontrollit të vendeve ose atij personal edhe kur kontrolli nuk shoqërohet me masën e sekuestrimit, për sa kohë që ai mbart në vetvete mundësinë për të cenuar të drejtat dhe liritë themelore (*shih vendimin nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa, sikurse u theksua më lart, nëse nga kontrolli nuk gjenden sende për t’u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t’i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual. Në këtë drejtim, edhe GJEDNJ-ja, posaçërisht në lidhje me kuadrin ligjor shqiptar, ka evidentuar se ankimi kushtetues individual përbën një mjet në dispozicion për shqyrtimin e pretendimeve që lidhen me kontrollin (*shih Radovan Çela kundër Shqipërisë, datë 20.1.2026, § 57*).

21. Në të njëjtën linjë, GJEDNJ-ja është shprehur se, pasi kontrolli të jetë kryer ose personi në fjalë të jetë vënë në dijeni të ekzistencës së urdhrit të kontrollit, duhet të ekzistojë një procedurë përmes së cilës ai të mund të kundërshtojë bazën ligjore dhe faktike të këtij urdhri, si dhe të marrë dëmshpërblim në rast se kontrolli është urdhëruar ose ekzekutuar në mënyrë të paligjshme (*shih Reznik kundër Ukrainës, datë 23.1.2025, §81*). Megjithatë, duke iu referuar parashikimeve aktuale ligjore, sikurse është edhe rasti i kërkuesit, Gjykata vëren se, ndonëse vendimet për kontrollin janë të paankimueshme drejtpërdrejt, kur kontrolli pasohet nga sekuestrimi i sendeve, individit mund t’i paraqesë pretendimet për ligjshmërinë dhe mënyrën e kryerjes së tij në kuadër të ankimit kundër vendimit të sekuestros dhe, pas shterimit të këtij mjeti, përmes ankimit kushtetues individual. Për

rrjedhojë, për sa kohë kërkuesi ka pasur mundësi t'i paraqesë pretendimet e tij për kontrollin në kuadër të ankimit kundër sekuestrimit dhe më pas në ankimin kushtetues individual, pretendimi për mungesën, në vetvete, e një mjeti juridik për kundërshtimin e kontrollit është haptazi i pabazuar. Megjithatë, ekzistenca e këtyre mjeteve juridike nuk përjashton shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkuesit lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore që ai pretendon se janë cenuar nga kontrolli, përfshirë vlerësimin nëse autoritetet gjyqësore kanë ofruar mbrojtje efektive dhe kanë dhënë përgjigje të arsyetuara ndaj këtyre pretendimeve.

22. Për sa i përket pretendimit për cenimin e integritetit fizik dhe personal, të garantuar nga neni 37, pika 3, i Kushtetutës, Gjykata vëren se ai lidhet me kontrollin vetjak të kërkuesit, të kryer nga oficerët e Policisë Gjyqësore sipas procesverbalit të datës 21.5.2024. Ndërsa pretendimet për cenimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të fshehtësisë së korrespondencës lidhen me aksesimin e synuar ose eventualisht të realizuar të përmbajtjes së telefonit të sekuestruar përmes kopjimit, ruajtjes dhe përdorimit të mundshëm të të dhënave të memorizuara në të. Megjithëse këto veprime procedurale janë të ndërlidhura dhe kanë ndodhur në kuadër të së njëjtës procedurë, ato prekin në mënyra të ndryshme të drejtat themelore, për shkak të natyrës, objektit dhe shkallës së ndërhyrjes që sjellin. Për rrjedhojë, Gjykata do t'i analizojë ato në kuadër të së drejtës për jetë private, duke mbajtur parasysh garancitë e veçanta të neneve 35, 36 dhe 37, pika 3, të Kushtetutës.

23. Në lidhje me të drejtën për proces të rregullt ligjor, Gjykata ka theksuar se, përjashtimisht, në rastin e kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor i konsideron si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në elemente të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 44, datë 29.7.2025; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, në aspektin procedural, kërkuesi ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, me argumentin se gjykatat nuk kanë identifikuar se cilat sende do të merreshin nga kontrolli dhe për më tepër nuk kanë përmendur nominalisht kërkuesin, për të cilin duhet të kishte një dyshim konkret dhe të justifikuar. Po sipas kërkuesit, vendimet gjyqësore bien në kundërshtim me vendimin njësuës të Gjykatës së Lartë nr. 1/2017. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, me argumentin se vendimet gjyqësore të kundërshtuara bien ndesh me vendime të mëparshme të Gjykatës së Lartë, sepse ato nuk kanë analizuar mungesën e autorizimit individual për kontrollin personal të kërkuesit. Gjykata vëren se, pavarësisht mënyrës sesi është emërtuar nga kërkuesi, ky argument nuk evidenton një trajtim të ndryshëm të tij në raport me persona të tjerë në situata të njëjta ose të krahasueshme, por lidhet, në thelb, me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal, respektimin e jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, ai nuk ngre një çështje autonome në drejtim të nenit 18 të Kushtetutës dhe do të shqyrtohet në kuadër të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për të njëjtat arsye, edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, i mbështetur në të njëjtin argument, nuk ngre një çështje kushtetuese autonome, ndaj do të merret në konsideratë në kuadër të shqyrtimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

25. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e argumenteve mbi të cilat kërkuesi ka mbështetur pretendimet e tij, çmon t'i trajtojë ato në drejtim të së drejtës substanciale për jetë private, konkretisht të mbrojtjes së të dhënave personale, fshehtësisë së korrespondencës dhe integritetit vetjak, të garantuara nga nenet 35, 36 dhe 37, pika 3, të Kushtetutës. Në këtë pikë, Gjykata vë në

dukje se për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të këtyre të drejtave substanciale, ajo niset nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, pasi, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, u takon atyre gjykatave që, krahas zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të marrin në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë Gjykata instanca e fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 33, datë 20.5.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në zbatim të standardit të mësipërm, Gjykata do të ndalet në pretendimet me natyrë procedurale të kërkuesit vetëm për atë sa ato ndikojnë në mbrojtjen e së drejtës substanciale për jetë private. Konkretisht, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit lidhen, në thelb, me faktin nëse gjykatat kanë verifikuar në mënyrë efektive dhe të arsyetuar ekzistencën e kushteve konkrete që mund të justifikonin kontrollin vetjak dhe sekuestrimin e telefonit celular, si dhe aksesimin e synuar ose eventualisht të realizuar të përmbajtjes së tij, kopjimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të memorizuara në të. Në këtë kuadër, Gjykata do të verifikojë nëse ato kanë analizuar ligjshmërinë, interesin publik dhe proporcionalitetin e secilës prej këtyre ndërhyrjeve, sipas kritereve të nenit 17 të Kushtetutës, si dhe nëse kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për pretendimet thelbësore të kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson t'i shqyrtojë këto pretendime në këndvështrim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe efektivitetit të kontrollit gjyqësor*, si aspekte procedurale të së drejtës për jetë private.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të së drejtës për jetë private në drejtim të mbrojtjes të të dhënave personale, fshehtësisë së korrespondencës dhe integritetit vetjak - në aspektin procedural

B.1.1 Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit dhe të së drejtës për një kontroll gjyqësor efektiv

27. Kërkuesi ka pretenduar se sekuestrimi i telefonit të tij celular është kryer në mënyrë të paligjshme, pa një vendim gjyqësor për kontroll personal dhe pa respektimin e garancive procedurale të parashikuara nga ligji. Sipas tij, oficeri i Policisë Gjyqësore ka tejkaluar autorizimin për kontrollin e ambienteve të shoqërisë, duke e shtrirë atë në kontroll personal pa bazë ligjore. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se sekuestrimi ka qenë joproporcional dhe se, nëse organi i akuzës do ta konsideronte të nevojshëm kontrollin e tij personal, duhej të kishte kërkuar paraprakisht autorizim gjyqësor. Sipas kërkuesit, qëndrimi i Prokurorisë së Posaçme se sekuestrimi është mbështetur në vendimin për kontrollin e vendeve është i gabuar dhe se ky subjekt ka pranuar se nuk ka kërkuar autorizim për kontrollin personal ndaj tij. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se kontrolli është kryer vetëm pasi është konstatuar prania e tij në ambientet e shoqërisë, megjithëse më parë nuk kishte pasur dyshime konkrete ndaj tij. Po sipas tij, gjykatat nuk kanë identifikuar se cilat sende ose të dhëna synoheshin të merreshin nga kontrolli, se vendimet gjyqësore bien në kundërshtim me vendimin njësoj të Gjykatës së Lartë nr. 1/2017 dhe se ato nuk kanë analizuar mungesën e autorizimit individual për kontrollin personal të tij. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë verifikuar as nëse aksesimi i synuar i përmbajtjes së telefonit dhe përpunimi i të dhënave të memorizuara në të do të kufizoheshin sipas llojit të komunikimeve, subjekteve dhe periudhës kohore që lidheshin me objektin e hetimit, si dhe nëse ishin parashikuar garanci për përjashtimin dhe asgjësimin e të dhënave që nuk kishin lidhje me hetimin.

28. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka parashtruar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi sekuestrimi i telefonit celular të tij nuk është bërë mbi bazën e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë që lidhet me kontrollin personal, por mbi bazën e vendimit të kësaj gjykate që lidhet me kontrollin e vendeve ose ambienteve. Sipas tij, kontrolli personal i personave që mbanin pozicione kyçe në shoqëritë tregtare, të cilat kanë rezultuar fituese në disa procedura

prokurimi, ishte i nevojshëm, me qëllim sigurimin e provave dokumentare dhe atyre elektronike për të qartësuar rrethanat e faktit objekt hetimi. Po kështu, ky subjekt ka prapësuar se për kërkuesin nuk është kërkuar fillimisht kontrolli personal dhe i banesës, pasi kur është paraqitur kërkesa e organit të prokurorisë ai ndodhej jashtë vendit. Sipas këtij subjekti, kërkuesi është gjendur në ambientet e shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k. në kohën kur është ushtruar kontroll dhe me iniciativë të oficerit të Policisë Gjyqësore, bazuar në nenin 205, paragrafi 4, të KPP-së, është bërë kontrolli personal i tij si administrator i shoqërisë dhe sekuestrimi i telefonit. Ky sekuestrim, sipas subjektit të interesuar, është bërë brenda objektit të kontrollit të vendeve të lejuara me vendim gjykatë, por nuk mund të konsiderohet rastësor. Për rrjedhojë, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se ndërhyrja në jetën private të kërkuesit është e ligjshme, e parashikuar dhe e rregulluar nga dispozita ligjore si dhe proporcionale.

29. Në lidhje me të drejtën për jetë private, Gjykata ka vlerësuar se ajo nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ndër të cilat përfshihen neni 35, për mbrojtjen e të dhënave personale, neni 36, për lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës, neni 37, për paprekshmërinë e banesës (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 52, datë 1.12.2011; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata evidenton se neni 37 garanton edhe mbrojtjen e paprekshmërisë nga kontrolli vetjak (*shih paragrafët 35–37 të vendimit*).

30. Neni 35 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij dhe se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, e garantuar nga neni 35 i Kushtetutës, përshtohet nga fryma se përpunimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Qëllimi i kushtetutëbërësit në parashikimin e kësaj dispozite kushtetuese ka qenë garantimi i një hapësire të nevojshme, brenda së cilës individit mund të zhvillojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në këtë kuadër, është e drejtë e individit të vendosë vetë për mënyrën dhe masën e paraqitjes së të dhënave të tij personale përpara të tjerëve dhe publikut në tërësi (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se sanksionimi në këtë dispozitë i parimit të mosdetyrimit për bërjen publike të të dhënave personale përbën garanci kushtetuese (*shih vendimin nr. 52, datë 1.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se neni 35 garanton mbrojtjen e individit nga përpunimi i pakufizuar i të dhënave personale dhe se kjo mbrojtje nuk kushtëzohet nga forma e regjistrimit ose e ruajtjes së tyre. Për rrjedhojë, edhe të dhënat personale të regjistruara në formë elektronike dhe të ruajtura në një pajisje inteligjente, si telefoni celular, përfshihen në fushën e mbrojtjes së kësaj dispozite kushtetuese (*shih vendimin nr. 44, datë 29.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Neni 36 i Kushtetutës parashikon se fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit është e garantuar. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo dispozitë kushtetuese mbron hapësirën brenda së cilës individit zhvillon personalitetin e tij dhe marrëdhëniet me individët e tjerë. Gjykata është shprehur se pjesë e korrespondencës janë edhe komunikimet e individit në ambiente publike me individë të tjerë në distancë që ai i bën me mesazhe të shkruara, zanore ose vizuale, duke përdorur pajisje kompjuterike, komunikime, të cilat mund të regjistrohen, filmohen ose fotografohen rastësisht gjatë zbatimit të masave të veçanta, veçanërisht të mbikëqyrjes vizuale (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 52, datë 1.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se fshehtësia e korrespondencës nuk kushtëzohet nga përmbajtja ose forma e pasqyrit të saj dhe as nga mënyra ose mjeti përmes të cilit realizohet komunikimi. Për rrjedhojë, mesazhet elektronike, përfshirë postën elektronike, SMS-të, MMS-të dhe komunikimet përmes aplikacioneve të mesazheve të çastit, përbëjnë forma korrespondence

dhe përfshihen në mbrojtjen e nenit 36 të Kushtetutës. Kjo mbrojtje shtrihet edhe te komunikimet elektronike të realizuara përmes teknologjive të reja të informacionit, përfshirë edhe nëpërmjet një telefoni inteligjent (*shih vendimin nr. 44, datë 29.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues i ndërhyrjeve në të drejtën për jetë private kërkon, fillimisht, identifikimin e ndërhyrjes dhe të mënyrës në të cilën ajo është realizuar dhe, më pas, verifikimin nëse ndërhyrja ka qenë e parashikuar nga ligji, ka ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe ka qenë proporcionale me gjendjen që e ka diktuar atë. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se sekuestrimi i një telefoni celular si send fizik dhe aksesimi i përmbajtjes së tij përbëjnë ndërhyrje të lidhura, por të dallueshme. Në këtë drejtim, sekuestrimi i një telefoni celular, kur kryhet me qëllim zbulimin dhe marrjen e të dhënave të memorizuara në të, nuk përbën vetëm sekuestrim të sendit në vetvete. Duke pasur parasysh funksionin e telefonit inteligjent për ruajtjen, përpunimin dhe shkëmbimin e një sasive të konsiderueshme informacioni personal, sekuestrimi i tij për këtë qëllim përbën edhe ndërhyrje në të dhënat personale dhe korrespondencën e ruajtur në të. Nxjerrja, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave të memorizuara në telefon, si veprime teknike për sigurimin e provës, si dhe kërkimi, analiza, përzgjedhja dhe marrja e të dhënave me rëndësi për hetimin, si veprime me natyrë hetimore, përbëjnë forma të përpunimit që ndërhyjnë në të drejtat e garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 44, datë 29.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata ka dalluar, gjithashtu, sekuestrimin e pajisjes elektronike dhe veprimet teknike të domosdoshme vetëm për sigurimin e integritetit të provës nga veprimtaria hetimore që konsiston në kërkimin, analizën, përzgjedhjen dhe marrjen e të dhënave me rëndësi për hetimin. Për shkak të intensitetit më të lartë të ndërhyrjes në jetën private, veprimet e kategorisë së dytë duhet, në parim, të autorizohen paraprakisht me vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përcakton objektin, mënyrën dhe kufijtë e zbatimit të masës. Në rastet e urgjencës, sekuestrimi i pajisjes dhe sigurimi i përkohshëm i të dhënave mund të kryhen me iniciativë të Policisë Gjyqësore, por urgjenca duhet të jetë reale, konkrete dhe e argumentuar, ndërsa kjo nuk u jep organeve proceduese të drejtën për të kërkuar, analizuar, përzgjedhur dhe marrë të dhënat pa autorizimin gjyqësor të nevojshëm. Ndërhyrja duhet të shoqërohet, gjithashtu, me garanci për kufizimin objektiv, material dhe kohor të kërkimit, minimizimin e përpunimit, ndarjen e të dhënave me rëndësi për hetimin nga ato që nuk lidhen me të dhe ushtrimin e një kontrolli gjyqësor real dhe efektiv (*shih vendimin nr. 44, datë 29.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në të njëjtën linjë, GJEDNJ-ja ka theksuar se për sa u përket kontrolleve dhe sekuestimeve, ligji vendas duhet t'i ofrojë individit mbrojtje kundër ndërhyrjes arbitrare në të drejtat e nenit 8 të KEDNJ-së. Pavarësisht nga marzhi i vlerësimit që GJEDNJ-ja u njeh shteteve kontraktuese, ajo duhet të jetë veçanërisht vigjilente kur autoritetet janë të autorizuar sipas ligjit vendas për të urdhëruar dhe kryer kontrolle pa një vendim gjyqësor. Për mbrojtjen e individëve nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve në të drejtat e garantuara nga neni 8 i KEDNJ-së kërkohet një kuadër ligjor i qartë dhe kufizime shumë të rrepta mbi këto kompetenca (*shih Mukhtarli kundër Azerbajjanit dhe Gjeorgjisë, datë 5.9.2024, § 216, 217; Brazzi kundër Italisë, datë 27.9.2018, § 41*). Po kështu ajo ka pohuar se kontrolli i përmbajtjes së një telefoni celular - i cili përbën një masë që ndërhyr seriozisht në jetën private dhe korrespondencën e një personi - nuk mund të jetë në përputhje me nenin 8 të KEDNJ-së nëse i lihet diskrecionit të pakufizuar të një prokurori; neni 8 kërkon lëshimin e një vendimi nga një organ i pavarur kur është në rrezik ndërhyrja në privatësinë e një personi (*shih Dumitru Popescu kundër Rumanisë (nr. 2), datë 26.4.2007, §71*). Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka pranuar se mungesa e një vendimi paraprak mund të balancohet nga disponueshmëria e një shqyrtimi gjyqësor *ex post factum* si të ligjshmërisë ashtu edhe të domosdoshmërisë së masës në fjalë. Në veçanti, shqyrtimi nga gjykatat kombëtare i një mase që ndërhyr në të drejtat e garantuara nga neni 8 duhet të ofrojë një mjet të përshtatshëm juridik për personin në fjalë, me kusht që

gjyqtari të shqyrtojë në mënyrë efektive ligjshmërinë dhe justifikimin për masën e kundërshtuar dhe, kur është e përshtatshme, të përjashtojë nga procesi penal provat e mbledhura (*shih Brazzi kundër Italisë, datë 27.9.2018, §§ 44–45*).

35. Për sa i takon nenit 37 të Kushtetutës, ndërsa në jurisprudencën e deritanishme ai është trajtuar si pjesë e mbrojtjes të së drejtës për jetë private në drejtim të paprekshmërisë së banesës, në rastin konkret, Gjykata çmon të shqyrtojë nëse në këtë mbrojtje përfshihet edhe garancia e integritetit personal që lidhet me kontrollin vetjak, sipas pikës 3 të këtij neni. Në funksion të kësaj analize, Gjykata vëren se neni 37, pika 3, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik. Ndryshe nga pika 2 e këtij neni, pika 3 nuk ia delegon ligjvënësit përcaktimin e rasteve në të cilat mund të ushtrohet kontrolli vetjak, por lejon këtë ndërhyrje vetëm në rastet përjashtimore të parashikuara shprehimisht prej saj.

36. Në këtë drejtim, Gjykata mban në konsideratë edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës koncepti i “jetës private” përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të personit. GJEDNJ-ja ka theksuar, gjithashtu, se liria e individit për të marrë vendime për veten, pra autonomia personale, përbën një parim të rëndësishëm që qëndron në themel të interpretimit të garancive të nenit 8 të KEDNJ-së (*shih Gillan dhe Quinton kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12.1.2010, § 61*).

37. Referuar përmbajtjes së nenit 37, pika 3, të Kushtetutës dhe standardeve të mësipërme të GJEDNJ-së, Gjykata çmon se kontrolli vetjak brenda procesit penal nuk përbën vetëm ndërhyrje në integritetin fizik dhe moral të personit, por për shkak të natyrës së tij si veprim fizik shtrëngues që synon kërkimin e sendeve mbi personin, prek edhe autonominë personale dhe sferën e jetës së tij private. Për rrjedhojë, ndonëse Gjykata deri më tani e ka trajtuar nenin 37 si pjesë të mbrojtjes së jetës private në aspektin e paprekshmërisë së banesës, vlerëson se edhe kontrolli vetjak, i rregulluar nga pika 3 e këtij neni, hyn në sferën e kësaj të drejte, për sa kohë që mbron personin nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve publike në trupin dhe autonominë e tij personale. Duke e lejuar kontrollin vetjak në kuadër të një procesi penal, kushtetutëbërësi e ka lidhur ndërhyrjen në jetën private me rastet e parashikuara shprehimisht nga KPP-ja, në përmbushje të kriterit të kufizimit “vetëm me ligj”, si dhe me interesin publik të administrimit të drejtësisë. Megjithatë, në këndvështrim të nenit 17 të Kushtetutës, edhe në rastet e kontrollit të ushtruar gjatë procesit penal, ushtrimi i kësaj kompetence nuk përjashtohet nga kontrolli kushtetues i proporcionalitetit. Ky parim konkretizohet përmes garancive procedurale dhe kushteve të parashikuara nga KPP-ja, të cilat synojnë të sigurojnë që ndërhyrja të mos shkojë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e qëllimit legjitim të administrimit të drejtësisë.

38. Për sa i përket aspektit procedural të së drejtës për jetë private, Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por kërkon edhe një shqyrtim real të pretendimeve të palëve dhe një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Po kështu, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin gjithashtu edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element thelbësor i një vendimi të drejtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 51, datë 20.6.2024; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, edhe pse

detyrimi për garantimin e këtij standardi nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, Gjykata ka theksuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, ajo gjykatë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 51, datë 20.6.2024; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 79, datë 14.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Duke pasur parasysh standardet e mësipërme, Gjykata do të analizojë nëse gjykatat e zakonshme u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuarit lidhur, së pari, me ligjshmërinë e kontrollit vetjak dhe të sekuestrimit të telefonit celular dhe, së dyti, me veprimet e synuara ose të realizuara për sigurimin teknik të të dhënave dhe për kërkimin, analizën, përzgjedhjen ose marrjen e tyre, si ndërhyrje të dallueshme, por të lidhura, në të drejtën për jetë private. Në këtë kuadër, Gjykata do të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme kanë shqyrtuar në mënyrë efektive dhe kanë arsyetuar, në dritën e kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës, ligjshmërinë, qëllimin dhe proporcionalitetin e secilës prej këtyre ndërhyrjeve, pra nëse secila prej tyre ishte e parashikuar në ligj, ndiqte një interes publik dhe ishte proporcionale me qëllimin e synuar.

41. Në rastin konkret Gjykata vëren se në kuadër të hetimeve për procedimin penal nr. 17, datë 25.1.2021, fillimisht Prokuroria e Posaçme i ka paraqitur kërkesë gjykatës për kontrollin personal të 12 shtetasve, të ndryshëm nga kërkuari. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 299/2024, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lejimin e kontrollit personal të këtyre shtetasve. Gjykata evidenton se kërkuari *nuk përfshihet* në personat ndaj të cilëve është lejuar kontrolli personal. Njëkohësisht Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë edhe për kontrollin e banesave, ambienteve dhe zyrave të disa individëve dhe shoqërive të përfshira në hetim, ndër të cilat edhe të shoqërisë në të cilën është administrator kërkuari. Këto kërkesa janë pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 300/2024, me të cilin është lejuar, ndër të tjera, kontrolli i zyrave të selisë së shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k.

42. Në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 300/2024 për kontrollin e ambienteve të shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k., oficerët e Policisë Gjyqësore kanë kryer edhe kontrollin personal të kërkuarit, i cili ndodhej në këto ambiente, dhe i kanë sekuestruar telefonin celular me dy karta SIM. Kërkuari nuk ishte përfshirë ndër personat për të cilët ishte lejuar kontrolli personal me vendimin nr. 299/2024. Sipas procesverbalit të kontrollit personal, veprimi është kryer duke iu referuar neneve 202 –207 dhe 298 të KPP-së, ndërsa në procesverbalin për sekuestrimin e provës materiale është referuar vendimi nr. 299/2024 dhe nenet 300 dhe 301 të KPP-së. Procesverbali i kontrollit është nënshkruar nga kërkuari në prani të një personi të besuar, ndërsa sekuestrimi është arsyetuar me rrezikun e ndryshimit ose humbjes së sendit.

43. Gjykata evidenton se kërkuari ka ushtruar mjetet procedurale të parashikuara nga ligji, duke kundërshtuar ligjshmërinë e sekuestrimit dhe kërkuar kthimin e telefonit celular. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 488 akti, datë 19.9.2024, ka vlerësuar se kontrolli është, si rregull, veprimi procedural që i paraprin sekuestrimit dhe bën të mundur realizimin e tij. Sipas saj, sekuestrimi i telefonave me qëllim kopjimin e të dhënave duhet të mbështetet në një vendim gjyqësor të arsyetuar për kontrollin personal ose të banesës, ndërsa, përjashtimisht, kontrolli dhe sekuestrimi mund të kryhen nga Policia Gjyqësore në rastet e flagrancës. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka çmuar se në rastin konkret ekzistonte dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprave penale

dhe se kontrolli synonte gjetjen e gjurmëve dhe sekuestrimin e provave materiale që mund t'i shërbenin hetimit, përfshirë pajisjet elektronike. Po sipas saj, vendimi që kishte autorizuar kontrollin parashikonte se këqyrja dhe ekspertimi i këtyre pajisjeve duhej të kufizoheshin vetëm në të dhënat kompjuterike që lidheshin ngushtësisht me objektin e hetimit, duke përjashtuar të dhënat që nuk kishin lidhje me veprën penale. Po kështu, ajo ka vlerësuar se disa nga pretendimet e kërkuesit lidheshin me thelbin e vendimit të kontrollit, i cili ishte i paankimueshëm. Për pretendimin se kërkuesi nuk ishte përfshirë në vendimin për kontrollin personal, gjykata ka çmuar se veprimi i organit procedues nuk ishte në kundërshtim me ligjin, pasi, sipas nenit 205 të KPP-së, gjatë kontrollit të vendeve mund të kontrollohen edhe personat e pranishëm, kur çmohet se ata mund të fshehin prova materiale ose sende që i përkasin veprës penale. Sipas saj, kërkuesi ndodhej në ambientet ku po kryhej kontrolli dhe atij i ishte sekuestruar një send që përfshihej në objektin e kontrollit të autorizuar për ambientet.

44. Vendimi është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka vlerësuar se, sipas nenit 202 të KPP-së, kontrolli personal ose ai i vendeve autorizohet, si rregull, me vendim gjyqësor, kur ka arsye të bazuara për të menduar se një person fsheh mbi vete prova materiale të veprës penale. Sipas saj, ligji procedural penal nuk parashikon ankim të veçantë kundër vendimit të kontrollit, për shkak të urgjencës së veprimeve gjatë hetimeve paraprake dhe nevojës për të ruajtur efektivitetin e kërkimit dhe sekuestrimit të provave materiale. Kjo gjykatë e ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë se, përjashtimisht, sipas nenit 205 të KPP-së, gjatë ekzekutimit të kontrollit të vendeve mund të kontrollohen edhe personat e pranishëm, kur organi procedues krijon dyshimin se ata mund të fshehin prova materiale ose sende që i përkasin veprës penale. Në rastin konkret, ajo ka çmuar se kontrolli personal i kërkuesit ishte justifikuar nga prania e tij në ambientet ku po kryhej kontrolli dhe nga dyshimi i krijuar gjatë ekzekutimit të tij se telefoni celular mund të përmbante të dhëna të lidhura me faktet objekt hetimi. Po sipas gjykatës, neni 301 i KPP-së lejonte sekuestrimin me iniciativë nga Policia Gjyqësore, të pasuar nga kontrolli dhe vlefhtësimi i tij nga prokurori brenda afatit ligjor 48-orësh, ndërsa në rastin konkret veprimet ishin kryer bazuar në nenet 205 dhe 300 të KPP-së. Për rrjedhojë, ajo ka vlerësuar të ligjshëm sekuestrimin e telefonit celular dhe vendimin e Prokurorisë së Posaçme të datës 22.5.2024 për vlefhtësimin e tij. Gjithashtu, ka çmuar se në fazën e hetimeve paraprake, prokuroria vendos për fatin e sendeve të sekuestruara në cilësinë e provave materiale dhe se kthimi i tyre urdhërohet kur ato kanë përmbushur nevojat e hetimit ose janë bërë të panevojshme, rrethana që nuk mund të konsideroheshin të verifikuara në atë moment.

45. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së dhe se gjykatat më të ulëta u kishin dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit. Për pretendimin se kontrolli personal nuk ishte autorizuar me vendim gjyqësor, ai ka mbajtur qëndrimin se, sipas nenit 205 të KPP-së, organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm kur çmon se ata mund të fshehin prova materiale ose sende që i përkasin veprës penale. Po kështu, ai ka vlerësuar se, në fazën e hetimeve paraprake, prokuroria vendos për fatin e sendeve të sekuestruara që janë në funksion të hetimit. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka çmuar se nuk konstatohet moszbatim i ligjit penal material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, shkelje procedurale që sillnin pavlefshmërinë e vendimit ose të akteve apo papërdorshmërinë e provave, si dhe kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

46. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ishte i individualizuar ndër personat ndaj të cilëve vendimi nr. 299/2024, kishte lejuar kontrollin personal. Ai është kontrolluar për shkak të pranisë së tij në ambientet ku po ekzekutohej vendimi nr. 300/2024, për kontrollin e vendeve dhe, si rezultat i kontrollit vetjak të ushtruar ndaj tij i është

gjetur dhe sekuestruar telefoni celular. Sikurse u parashtrua më lart, paankimueshmëria e drejtpërdrejtë e vendimit të kontrollit nuk përjashtonte shqyrtimin e pretendimeve për ligjshmërinë e veprimeve konkrete gjatë ekzekutimit të tij, në kuadër të ankimit kundër masës së sekuestrimit (shih paragrafin 16 të vendimit).

47. Gjykata eidenton, gjithashtu, se kërkuesi, duke kundërshtuar sekuestrimin e telefonit celular, ka pretenduar, në thelb, se kontrolli vetjak ndaj tij ishte kryer pa vendim gjyqësor dhe pa qenë të pranishme kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal për kontrollin e personave që ndodhen në vendin ku kryhet kontrolli. Për rrjedhojë, pretendimet e tij nuk lidheshin vetëm me nevojën dhe ligjshmërinë e sekuestrimit të telefonit në cilësinë e provës materiale, por edhe me ligjshmërinë e veprimit procedural përmes të cilit telefoni ishte gjetur dhe sekuestruar. Gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar se kontrolli i kërkuesit gjente mbështetje në nenin 205 të KPP-së, sipas të cilit, gjatë kontrollit të vendeve, organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm kur çmon se ata mund të fshehin prova materiale ose sende që i përkasin veprës penale. Në të njëjtën kohë, ato i janë referuar paankimueshmërisë së vendimit të kontrollit, duke e përligjur me urgjencën e veprimeve hetimore dhe nevojën për të ruajtur efektivitetin e kërkimit dhe sekuestrimit të provave. Megjithatë, nga arsyetimi i tyre nuk rezulton se kanë verifikuar dhe individualizuar rrethanat faktike konkrete mbi bazën e të cilave organi procedues kishte krijuar dyshimin se kërkuesi mund të fshihte mbi personin e tij prova materiale ose sende që i përkisnin veprës penale. Në veçanti, ato nuk kanë analizuar nëse dhe në çfarë mënyre prania e tij në ambientet ku kryhej kontrolli dhe cilësia e administratorit të shoqërisë krijonin, në rrethanat konkrete, dyshimin e kërkuar nga ligji se ai mund të fshihte prova ose sende mbi personin e tij. Në këtë drejtim, Gjykata mban në konsideratë edhe se nga aktet e administruara nuk rezulton që kërkuesit t'i ishte atribuar cilësia e personit në hetim dhe as organi i prokurorisë nuk ka pretenduar se ai kishte një cilësi të tillë. Ndonëse kjo rrethanë nuk përjashton *per se* mundësinë e ushtrimit të kontrollit vetjak ndaj tij në kushtet e parashikuara nga ligji, ajo përforcon nevojën që gjykatat të verifikonin dhe individualizonin rrethanat konkrete mbi bazën e të cilave ishte krijuar dyshimi që justifikonte këtë ndërhyrje.

48. Gjykata vëren se kontrolli vetjak ka qenë veprimi procedural përmes të cilit është gjetur telefoni celular, ndërsa sekuestrimi ka përbërë pasojën e drejtpërdrejtë të këtij veprimi. Për këtë arsye, ligjshmëria e sekuestrimit nuk mund të shqyrtohej në mënyrë të shkëputur nga ligjshmëria e kontrollit vetjak që e kishte paraprirë. Gjykatat e zakonshme kishin detyrimin të verifikonin jo vetëm nëse telefoni mund të sekuestrohej në cilësinë e provës materiale dhe nëse sekuestrimi ishte vlefshëm nga prokurori, por, paraprakisht, edhe nëse kontrolli vetjak përmes të cilit ai ishte gjetur, ishte kryer në përputhje me kushtet e ligjit dhe me garancitë kushtetuese të së drejtës për jetë private. Nga vendimet objekt kundërshtimi nuk rezulton që ky verifikim të jetë kryer në mënyrë të plotë dhe efektive. Po kështu, për sa kohë që sekuestrimi i telefonit synonte aksesimin e të dhënave të ruajtura në të, verifikimi gjyqësor nuk mund të kufizohej vetëm te ligjshmëria e marrjes së sendit fizik, por duhej të shtrihej edhe tek objekti, shtrirja dhe garancitë e aksesimit të përmbajtjes së tij. Në këtë kuadër, gjykatat duhej të verifikonin, mbi bazën e pretendimeve dhe akteve të paraqitura, natyrën e veprimeve të kryera ose të synuara mbi të dhënat e telefonit dhe nëse ato kufizoheshin në sigurimin teknik të integritetit të provës ose shtriheshin në kërkimin, analizën, përzgjedhjen dhe marrjen e të dhënave me rëndësi për hetimin.

49. Po kështu, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë analizuar në mënyrë të arsyetuar nëse kontrolli vetjak dhe sekuestrimi i telefonit celular, si dhe qëllimi i këtij sekuestrimi për të mundësuar aksesimin në përmbajtjen e pajisjes, përmbushnin kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, ndonëse gjykatat e kanë identifikuar qëllimin e masave, duke e lidhur atë me sigurimin

e provave dhe mbarëvajtjen e procesit penal, ato nuk i kanë analizuar në mënyrë të mjaftueshme kriteret e ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të secilës ndërhyrje. Kështu, gjykatat janë përqendruar kryesisht në nenin 205 të KPP-së, në vleftësimin e sekuestrimit nga prokurori dhe në kompetencën e këtij të fundit për të vendosur për fatin e provave materiale gjatë hetimeve paraprake, por nuk rezulton të kenë verifikuar dhe arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme rrethanat konkrete që mund të përlligjin kontrollin vetjak të kërkuesit, domosdoshmërinë e tij dhe të sekuestrimit të telefonit në rrethanat konkrete të çështjes, raportin ndërmjet qëllimit të sigurimit të provës dhe shkallës së cenimit të të drejtave të kërkuesit, si dhe nëse i njëjti qëllim mund të arrihej përmes një mase tjetër më pak kufizuese. Po kështu, ato nuk kanë shqyrtuar nëse aksesimi i synuar ose eventualisht i realizuar i përmbajtjes së telefonit ishte i kufizuar në të dhënat me rëndësi për hetimin dhe nëse shoqërohej me garanci të mjaftueshme kundër një kërkimi ose përpunimi të pakufizuar, përfshirë ndarjen dhe trajtimin e të dhënave që nuk kishin lidhje me hetimin.

50. Në këtë këndvështrim, edhe Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji, duhej t'u jepte përgjigje pretendimeve të kërkuesit me natyrë kushtetuese. Në veçanti, ajo duhej të vlerësonte nëse gjykatat më të ulëta kishin identifikuar rrethanat konkrete që mund të justifikonin kontrollin personal të kërkuesit dhe sekuestrimin e telefonit, si dhe nëse kishin kontrolluar ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes së mëtejshme në të dhënat personale dhe korrespondencën përmes aksesimit të synuar në përmbajtjen e tij, shtrirjen e veprimeve të synuara ose të realizuara mbi të dhënat dhe garancitë për të dhënat që nuk kishin lidhje me hetimin. Gjykata e Lartë është mjaftuar me konstatimin se gjykatat më të ulëta kishin arsyetuar në mënyrë logjike dhe se neni 205 i KPP-së lejon kontrollin e personave të pranishëm. Nga përmbajtja e vendimit të saj nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë shqyrtuar nëse kushtet e përcaktuara nga kjo dispozitë ishin përmbushur në rastin e kërkuesit dhe as nëse kontrolli dhe sekuestrimi i telefonit ishin në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se, ndonëse vendimi i kontrollit ishte *per se* i paankimueshëm, gjykatat kishin detyrimin të shqyrtonin ligjshmërinë e kontrollit vetjak në kuadër të ankimit kundër sekuestrimit të ardhur si rezultat i tij.

51. Gjykata rithekson se, në respektim të parimit të subsidiaritetit, interpretimi dhe zbatimi i dispozitave të ligjit procedural penal u përket, në radhë të parë, gjykatave të zakonshme dhe, në veçanti, Gjykatës së Lartë. Në këtë kuadër, nuk i takon Gjykatës të përcaktojë nëse, sipas nenit 205 të KPP-së, në rastin konkret ishin plotësuar kushtet ligjore për kontrollin vetjak të kërkuesit, por të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme kanë ushtruar një kontroll real dhe efektiv mbi ndërhyrjet e kundërshtuara dhe u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Për sa kohë, sipas analizës së mësipërme, një kontroll i tillë nuk rezulton të jetë ushtruar në mënyrë të plotë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për jetë private, në aspektin procedural të së drejtës për një kontroll gjyqësor efektiv dhe të standardit të arsyetimit të vendimit, është i bazuar.

52. Në këto rrethana, Gjykata çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet dhe çështja t'i kthehet për rishqyrtim asaj gjykate. Në rishqyrtimin e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata e Lartë duhet të mbajë parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, standardet e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese për ekzistencën dhe individualizimin e shkaqeve konkrete që mund të përlligjin kontrollin vetjak dhe sekuestrimin, për dallimin ndërmjet veprimeve teknike të sigurimit të integritetit të provës dhe veprimeve hetimore të kërkimit e përpunimit të të dhënave, si dhe për përcaktimin e objektit dhe të shtrirjes së aksesit, kufizimin e përpunimit në minimumin e domosdoshëm dhe garantimin e një procedure për ndarjen dhe trajtimin e të dhënave që nuk lidhen me hetimin ose që gëzojnë mbrojtje të posaçme. Po kështu, ajo duhet të ushtrojë një

kontroll gjyqësor efektiv *ex post factum* të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të këtyre ndërhyrjeve (*shih vendimet nr. 44, datë 29.7.2025; nr. 42, datë 1.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Nisur nga sa më sipër, për sa kohë Gjykata e gjeti të bazuar pretendimin për mungesën e një shqyrtimi gjyqësor efektiv dhe të arsyetuar të ndërhyrjeve në të drejtën për jetë private dhe çështja do t'i dërgohet për rishqyrtim Gjykatës së Lartë, ajo vlerëson të mos ndalet më tej në shqyrtimin e aspektit substancial të kësaj të drejte kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata nuk do të shprehet as për kërkimin për asgjësimin e kopjeve të korrespondencës dhe të të dhënave personale të nxjerra nga telefoni. Në fakt, nga aktet e administruara nuk rezulton e përcaktuar në mënyrë të plotë nëse është kryer vetëm sigurimi teknik i të dhënave apo edhe kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e tyre, cila ka qenë shtrirja e këtyre veprimeve dhe cilat kategori të dhënash janë ruajtur. Për më tepër, shqyrtimi i këtij kërkimi varet nga përcaktimi paraprak i ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të këtyre veprimeve, çështje këto që duhet të shqyrtohen fillimisht nga gjykata e zakonshme.

55. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të pranohet pjesërisht, për sa i përket cenimit të së drejtës për jetë private në aspektin procedural të së drejtës për një kontroll gjyqësor efektiv dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-214, datë 6.2.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.6.2026.

Shpallur më 1.9.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Asim Vokshi, Marjana Semini